# DËSHMI ARKIVI

**A-454876**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Debati për pagat e magjistratëve, Rama u drejtohet drejtuesve të gjyqësorit: Të ulemi në një tryezë pun e, kërkojmë një zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/debati-per-pagat-e-magjistrateve-rama-u-drejtohet-drejtuesve-te-gjyqeso-i586864` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 11:29:13 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 11:25:39 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7915675719d798d8e24e98685bde94ea8a4007412592a23644a42fd53fa0d180` |
| TEKSTI | `0e29d6f6d37a0bda6ad2733bcbbfccd0c97f597bf7e91643f4c5646c56d0e489` |
| PAMJA | `2271faf95cb9c7aed84909f884140b4c17f5000e173ca90032a034b6105db144` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c19b2604f81b48243122e30d97f8550fe5c348b0134b4f2322425db44cdf1f2b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c19b2604f81b48243122e30d97f8550fe5c348b0134b4f2322425db44cdf1f2b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Debati për pagat e magjistratëve, Rama u drejtohet drejtuesve të gjyqësorit: Të ulemi në një tryezë pune, kërkojmë një zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë

TemA
18 Shtator 2026, 13:25Politika TEMA




Kryeministri Edi Rama ka reaguar përmes një postimi në rrjetin social X lidhur me debatin e ditëve të fundit për sistemin e pagave të magjistratëve.

Rama u ka bërë thirrje drejtuesve të institucioneve të gjyqësorit që të ulen në një tryezë të përbashkët pune, me synim gjetjen e një zgjidhjeje afatgjatë për pagat, duke ruajtur njëkohësisht ekuilibrin e piramidës shtetërore të pagave.

Në reagimin e tij, Rama shprehet se në tryezë mund të marrin pjesë edhe ekspertë të Këshillit të Europës dhe përfaqësues të Komisionit Europian për Efiçencën e Drejtësisë.

*"Uroj dhe besoj që përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor, që nga drejtuesit e dy këshillave dhe me radhë drejtuesit e institucioneve të gjyqësorit, do t'i përgjigjen pozitivisht ftesës për t'u ulur së bashku në një tryezë pune pa humbur kohë, e për të adresuar temën e sistemit të pagave të magjistratëve në funksion të një zgjidhjeje të qëndrueshme afatgjatë, e cila i garanton ata përgjithnjë po njëkohësisht garanton edhe ekuilibrin e përgjithëhershëm të piramidës shtetërore të pagave. Tryeza jonë do të mirëpresë edhe pjesëmarrjen e ekspertëve të Këshillit të Europës, si edhe kontributin e Komisionit Europian për Efiçencën e Drejtësisë.*

*Magjistratët e Shqipërisë nuk duhet ta harrojnë se shkalla e tyre deri dje e paimagjinueshme e pavarësisë dhe trajtimi i tyre me pagat më të larta në Republikën e Shqipërisë dhe ndër më të lartat në rajon, nuk ranë nga qielli, po mbajnë vulën e vullnetit të kësaj shumice qeverisëse, e cila nuk do konflikt me gjyqësorin po bashkëveprim institucional, në respekt të pavarësisë së ndërsjellë. E nëse kemi mosdakordësi, na takon t'i trajtojmë me urtësi dhe durim duke dhënë një shembull dinjiteti shtetëror për qytetarët tanë e njëkohësisht edhe për partnerët e Shqipërisë"*, shkruan Rama

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Gazo shiko hallin tënd, u martove apo jo?!"- Zegjineja debat me Bardhin pas mesnate në Kuvend!]

12:10 Politika / 7 komente

Presidenti Begaj dekreton ligjin për formulën e re të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve!

12:00 Politika

[Përfundon takimi i Ramës me drejtuesit politikë, fokusi te dokumentet “Besa” dhe “Prania Besnike”]

11:28 Politika / 4 komente

[Edmond Spaho: PD e ka mbështetur krijimin e Gjykatës Speciale, Berisha votoi pro ngritjes së komisionit të Dick Marty]

10:05 Politika / 8 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.